

**TENDERI 2022**

**SHËRBIMET PUBLIKE NË PASTRIMIN ,GJELBËRIM  
MIRMBAJTJE VARREZAVE E DEKOR**

**SPECIFIKIMET TEKNIKE  
METODOLOGJIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE , METODOLOGJIA E SHERBIMEVE**

### **(Permbledhse)**

Bashkia ka si qëllim ofrimin e shërbimeve të pastrimit ,gjelbërimit ,mirmbajtjes varrezave e dekorit në të gjithë territorin e saj me standarte dhe performancë sa më të lartë ,duke siguruar reduktimin e impakteve negative në shëndetin e njerzve dhe të mjedisit.

-Kompania private duhet të kryej shërbime në sektorin e pastrimit ,gjelbërimit ,mirmbajtjes varrezave e dekorit në zonën në Qënder të Bashkisë Rrogozhinë dhe në Njësit Administrative ,Gosë ,Lekaj,Kryevidh ,Sineballaj.

-Eshte parashikuar që në të gjithë territorin e Bashkisë Rrogozhinë do të kryhen këto shërbime ;

### **Ne sektorin e Pastrimit**

- Fshirja me fshese dore natën e mirmbajtje ditën në Bashkinë e Rrogozhinës për 365 ditë/pune është 64511 m<sup>2</sup>.  
Fshirja me fshese dore natën e mirmbajtje ditën në Bashkinë e Rrogozhinës për 182 ditë/pune është 106339 m<sup>2</sup>.
- Heqje,pastrimin ,transport mbetje urbane për 365 ditë/pune 210 kontenier 1100 litra
- Heqje,pastrimin ,transport mbetje urbane për 182 ditë/pune 70 kontenier 1100 litra
- Heqje,pastrimin ,transport mbetje urbane për 122 ditë/pune 50 kontenier 1100 litra
- Lagje rrugë e sheshe dy herë në ditë për 214 ditë/pune 64718 m<sup>2</sup> sipërfaqe
- Heqje transport mbetjesh inerte voluminoze për 182 dit/pune në të gjithë territorin

### **Ne sektorin e Gjelberimit**

- Mirmbajtje sipërfaqe me lule 1432 m<sup>2</sup> për 365 dite
- Mirmbajtje sipërfaqe me bar natyror 2318 m<sup>2</sup> për 365 dite
- Mirmbajtje rrugë e sheshe 2277 m<sup>2</sup> për 365 dite
- Mirmbajtje bordure e gjelbërt 2110 ml për 365 dite
- Mirmbajtje drurë dekorativ 1880 cop për 365 dite
- Mirmbajtje shkurre dekorativ 1092 cop për 365 dite

### **Ne sektorin e Mirmbajtjes Varrezave**

- Mirmbajtje sipërfaqe rrugë e sheshe 1970 m<sup>2</sup> për 365 dite
- Mirmbajtje sipërfaqe bar natyror 19353 m<sup>2</sup> për 365 dite
- Mirmbajtje drurë dekorativ 462 cop për 365 dite
- Mirmbajtje shkurre dekorative 324 cop për 365 dite
- Mirmbajtje rrethimi 800 ml për 365 dite
- Puntor shërbimi territori varrezash 1095 ditë/pune për 365 dite

### **Ne sektorin e Dekorit**

- F.Vendosje flamuj kombetar 25 cop sipas ditëve të festave
- F.Vendosje parrulla nga të 2 anet 30 cop sipas ditëve të festave
- Sherbim me gelqere 4800 m<sup>2</sup> për gjithë vitin
- Riparim Vendosje tabela qarkullimi rrugor 15 cop për gjithë vitin sipas rastit

## ➤ SEKTORI I PASTRIMIT

### 1.Fshirja manuale e rrugëve

#### 1.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht te fshije rrugët ,trotuaret ,sheshet natën e mirmbajtje ditën në të gjithë territorin e Bashkise Rrogozhinë në zonat e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **170850** m<sup>2</sup> në ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për Bashkine Rrogozhine (bashkëngjitur kësaj kontrate) dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate dhe preventive nr 1-1a.

Do të fshihen naten e mirmbahen ditën për 365 ditë/pune 64511 m<sup>2</sup>

Do te fshihen naten e mirmbahen ditën për 182 ditë/pune 106339 m<sup>2</sup>

#### 1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Sherbimi i fshirjes se rrugeve dhe tortuareve dhe shesheve me krah naten e mirmbajtje ditën konsiston ne :

- a. Fshirjen me fshese te gjithe rrugeve kryesore ,shesheve duke mbuluar siperfaqen e plote te tortuarit ne gjithe gjatesine lineare .
- b. Fshirjen dhe pastrimin me puntor te gjithe segmenteve te zena nga parkimi , ne momentin me te pershtatshem per pastrim.
- c .Operatori i sherbimit duhet te zbraze ,pastroje vendin perreth dhe te mbajë pastër cdo dite të gjithë koshat rrugor brenda zonës së kontraktuar . Sherbimi zbrazjes dhe pastrimit te ambjentit rreth tyre behet gjate nates.

#### 1.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.

b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontratues mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga sipërmarresja dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

#### **1.4 Rregulla për tu zbatuar**

a. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër çdo sipërfaqe rruge ,trotuari e sheshe në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

b. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit i shërbimit dhe do të penalizohet sipas parashikimit në nenit, Penalitete dhe Gjopa”

c. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

d. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

e. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

**f.** Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**g.** Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

**h.** Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

**i.** Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

**j.** Nën termin papastërti nënkuptohen të gjithë mbeturinat si: rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike, etj siç është përcaktuar në Nenin, "Përkufizimet".

## **1.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

## **1.6 Mirembajtja dhe pastrimi gjatë ditës i akseve kryesore**

Mbledhja e hedhurinave ditore në rruget kryesore.

## **1.7 Volumi i punimeve**

Autoriteti kontraktues ka parashikuar paraprakisht mirëmbajtjen e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të pastrojë dhe mirembajë të gjithë sipërfaqet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, nga ora 08.00-19.00

Keto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve për zonën e planifikuar.

## **1.8 Specifikimet teknike dhe metodologjia**

Sherbimi i mirembajtjes dhe pastrimit te tortuareve dhe konetave te akseve kryesore konsistojne ne :

Mbarevajtjen dhe pastrimin me puntore gjate dites te tortuareve dhe konetave te akseve kryesore, duke mbledhur dhe larguar te gjitha mbetjet e vogla dhe te medha te hedhura ne siperfaqet per mbulim si rezultat i aktivitetit tregetar dhe te kembesoreve,mbajtjen paster gjate dites te koshave rrugore dhe vendit rreth tyre,etj.

## **1.9 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

**a.**Mirembajtja dhe pastrimi i tortuareve do te behet gjate dites nga ora 10:00 der nr 18:00 sipas grafikut te miratuar nga Autoriteti kontraktor me qellim qe gjate dites e gjithe siperfaqja e tortuareve te jete e paster.

**b.** Grafikët e punimeve per realizimin e shërbimit të pastrimit te zones, pergatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

**c.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktoheh saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punetoreve qe do te punojne ne cdo segment rrugor..

**c.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**e.** Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mos përmbushjen e tyre.

## **1.10 Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër çdo gjatësi lineare te rrugeve trotuareve dhe shesheve sipas kushteve te kësaj kontrate.

**b.** Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të

shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të penalizohet sipas parashikimit në nenit \_\_ ”Penalitete dhe Gjoha”

c. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

### **1.11 Mjetet dhe pajisjet**

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

## **2.Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane.**

### **2.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e 280 kontenierëve me volum 1100 litra brenda zones se kontrates sipas preventivit Nr 2-2a-2b.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, zbrazje kontenierësh, per 365 dite.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në Bashkinë Rrogozhine dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate. Te gjithë kontenieret do te sigurohen nga punemarresi. Mirëmbajtja dhe siguria e kontenierëve do të kryhet nga punëmarrësi.

- Do te hiqen e transportohen mbetjet urbane nga 210 kontenjer per 365 dit/pune
- Do te hiqen e transportohen mbetjet urbane nga 70 kontenjer per 182 dit/pune
- Do te hiqen e transportohen mbetjet urbane nga 50 kontenjer per 122 dit/pune ne zonen e plazhit te Spilles

### **2.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a.Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike per mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre ne Landfillin e Elbasanit.

**b.** Në çmimin njësi të largimit të mbeturinave urbane përfshihet gjithashtu edhe dezinfektimi në përfundim, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo konteneri. Mund të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo konteneri, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

## **2.2 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve**

**a.** Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës së kontraktuar.

**b.** Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontratues sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëjës palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontratues.

**c.** Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoritetit kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

**d.** Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

**e.** Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërmbushjen e tyre.



## **2.4 Rregulla për tu zbatuar**

**a.** Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër pikën e grumbullimit të mbeturinave në përputhje me kushtet e kesaj kontrate.

**b.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në Nenin “Gjoha dhe penalitetet”

**c.** Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

**d.** Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontratues.

**e.** Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

**f.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

**g.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**h.** Me Mbeturina të Ngurta Urbane nënkuptohen të gjitha mbetjet dhe materialet që për çdo rast përshkruhen në Nenin 2 “Përkufizimet dhe sipas rregullores VKB Nr.1 dt. 05.02.2007.

**i.** Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

**j.** Në qoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penaltitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

**l.** Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

## **2.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

- 1.** Automjet teknologjik ,cope 2 per heqje dhe transport mbeturinash nga kontenieret me kapacitet mbajtes 10 ton siper me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash
- 2.** Automjet teknologjik ,cope 1 per heqje dhe transport mbeturinash nga kontenieret me kapacitet mbajtes 9 ton e siper , me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash
- 3.** Automjet teknologjik ,cope 1 per heqje dhe transport mbeturinash nga kontenieret me kapacitet mbajtes 6 ton e siper , me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash
- 4.** Kontenier mbeturinash ,280 cope ,qe do te vendosen ne vendet e percaktuara nga autoriteti kontraktues ,me kapacitet mbajtes me volum 1100 litra.Gjate stines se veres ne zonen e plazhit te Spilles 50 kontenier 1100 litra per 122 dit/ pune.

Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “ Specifikimet teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

## **2.6 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontratues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit. Operatori do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete sipas Nenit, "Penalitete dhe Gjoha".
- e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.
- f. Të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve duhet të identifikohen sipas numrit respektiv të pikës, që duhet të jetë lehtësisht i dukshëm për komunitetin. Operatori i shërbimit mund të të vendosë dukshëm numrat e pikave mbi njërin nga kontenieret apo ambjentet e tjerë rreth pikës sipas "Listës së pikave dhe vendodhjes së tyre".
- g. Detyrimisht të gjitha makinat duhet të shkruhen "Mbani paster qytetin Tuaj", duhet të prezantohen shpjegues për llojin e mbetjeve që mbledhen, orarin e largimit dhe mesazhe për edukimin ambjental.

## 2.7 Kushtet teknike për mjetet e transportit

- a.** Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave.
- b.** Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në NJA.
- c.** Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dh të lejojë kryerjen e një cikli të plotë (ngritjerm e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash.
- d.** Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vetë dhe nuk duhet që punëtorët të ngrenë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.
- e.** Makinat teknologjike duhet të jenë në gjendje të mirë, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërpreje për arësye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jenë të aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h.
- f.** Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjisllacionit në fuqi.
- g.** Dritat e përparme dhe të pasme duhet të jenë në gjendje të mirë dhe makinat duhet të jenë gjithashtu të pajisur me reflektorë. Dritë të bardhë të pasme për punën gjatë orëve të natës.
- h.** Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.
- i.** Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10 dhe 5 ton).
- j.** Të gjitha investimet, mirëmbajtjen dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit të pjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e të gjitha makinave dhe faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.
- k.** Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tillë situatë nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- l.** Makinat teknologjike duhet të lahen çdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjenik të mbetjeve.

**m.** Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregoj të gjitha informacionin për punën e bërë çdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe kilometrat. Përfaqësues të bashkisë mund të kenë akses tek libri ditor sipas kërkesës.

**n.** Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për çdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasi të), vajin dhe të tjerat aktivitete të mirëmbajtjes . Përfaqësues të bashkisë mund të kenë akses tek libri ditor sipas kërkesës.

**o.** Në qoftë se makinat teknologjike nu do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtjen nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

**p.** Çdo mjet duhet të jetë i lidhur përmes celularit me kompaninë në vazhdimësi.

**q.** Çdo mjet (duke përjashtuar motorciklin) duhet të jetë i paisur me shuesin e zjarrit 6 kg, trekëndëshin e sigurisë, si dhe krik hidraulike.

## **2.8 Menaxhimi i konteniereve**

**a.** Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesës fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontenierëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës. Kontraktuesi duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e të paktën 8 kontenierëve (min 5.5m \* 2.2m).

**b.** Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor dhe një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kontraktues duhet të mbajë një database GIS me të gjithë kontenierët, ku identifikohet pozicioni, numri, mosha, kushtet dhe riparimet. Shërbimet e bashkisë do të kenë akses të përhershëm në leximin e kësaj database.

**c.** Sipërmarrësi i shërbimit është i detyruar të zëvendësojë në mënyrë progresive 15% të kazaneve të dëmtuar apo të vjetër çdo vit kalendarik, me koston e tij. Konkretisht për Qytetin do blihen 100 (njëqind) kazanë metalik të xinguar 1100 litra, me mbulesë metalike dhe rrota, sipas normave EN DIN 840 dhe do të blihen në fund të çdo tremujori. Furnizimi dhe më pas ndarja do bëhet në marrëveshje me Autoriteti Kontraktor. Numri i kazaneve që do blihen sipas tremujorit do të jetë:

- Për tremujorin e parë dhe të katërt të vitit do blihen nga 20 (njëzet) kazanë.

- Për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit do blihen nga 30 (tridhjetë) kazanë.

Për mos realizim të blerjeve të kazanëve sipas tremujorëve, sipërmarrësit në fund të çdo tremujori situacione, do ti ndalet vlera e kazanëve të pa blerë.

## 2.9 Mirmbajtja e konteniereve

a. Kontinierët e dëmtuar sistematikisht duhet të zëvendësohen me një të riparuar, transportohen dhe rregullohen nga kontraktuesi. Kontraktuesi ka për detyrë të monitorojnë rregullisht gjendjen fizike të kontenierëve, dhe të mbajë një inventarë për të gjithë kontenierët, të cilin duhet ta raportojë tek Autoriteti Kontraktues. Në këtë inventar kontraktuesi duhet të japin sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme si shtesë e kontenierëve për të siguruar sipas pikës 3.1c. Për të riparuar kontenierët, kontraktuesi duhet të ketë një mjet të veçantë për transportin e kontenierëve për t'i riparuar ato në ambjentet e kompanisë.

b. Kontraktuesi duhet të mbajnë një rezervë prej 10 (dhjetë) kontenierësh, të cilët do të përdoren për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim. Dëmtimet e mundshme, të cilat duhet të riparohen brenda 5 ditëve të evidentimit, janë:

- rrotat
- kapakët
- dorezat
- deformime të ndryshme të kontenierit
- lyerja e kontenierëve, numri serial dhe barkodi

c. Përsa kohë kontenierët janë projektuar për një përdorim intesiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.

d. Kontraktuesi duhet të kenë në dispozicion materialet dhe stafin e përshtatshëm për të realizuar këtë shërbim si dhe një oficinë të pajisur me mjetet dhe paisjet e nevojshme.

## 2.10 Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 280 kontinjere 1100 litra sa here që do të kërkohej nga autoriteti kontraktor. Do të lajë dhe dezinfektojë 50 kontinjere në zonën e Spilles në sezonin e plazhit

## 2.11 Metodologjia

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.

4. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenerit.

## **2.12 Grafikët e punimeve**

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenerëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.
3. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

## **2.13 Mjetet dhe pajisjet**

1. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese (dezinfektues kimik) për dezinfektimin e kontenerëve.
2. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezinfektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenerëve.
3. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
4. Dezinfektimi dhe deratizimi kryhet me dezinfektues kimikë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë .

## **2.14 Rregulla për tu zbatuar**

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenerëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..
2. Të gjitha lëndët dezinfektuese dhe aromatike si dhe uji i përdorur për larjen dhe dezinfektimin e kontenerëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit e të tyre miratohet më parë nga organet shtetërore shëndetësore dhe më pas nga Autoriteti kontratues e Tiranës. Mos miratimi i lëndëve kimike të përdorura para përdorimit të tyre do të bëjë të pavlefshme këtë shërbim dhe si rezultat nuk mund të kryhet pagesa.

## **2.14 Personeli**

**a.** Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon mbetjet. Personelit nuk lejohet të kryejë riciklim në përfitim të tij apo të kompanisë gjatë orëve të punës së grumbullimit të mbetjeve në mënyrë që të evitohet humbja e kohës dhe nxitet grumbullimi. Riciklimi do të realizohet nga stafi dhe mjetet specifike. Gjatë transportit në landfill, punëtorët nuk duhet të shoqërojnë mjetin por duhet të ofrojnë të tjera shërbime pastrimi për qytetin.

**b.** Kushte e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shënja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

Pajimet minimale të kërkuara për stafin janë:

- Veshje me vizibilitet të lartë për periudhën e verës dhe dimrit
- Pantallona me vizibilitet të lartë
- Doreza
- Maska pluhuri
- Këpucë sigurie (pune)

Pajimet do të zëvendosohen dhe pastrohen kur të jetë e nevojshme nga kompania kështu që punonjësit do të paisen me to gjatë gjithë orëve të punës.

## **3. Mirmbajtje e pikave të grumbullimit të mbetjeve**

### **3.1 Volumi i punës**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar shërbimin për të gjitha pikave të grumbullimit të mbetjeve e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre përreth për të gjithë zonën e kontraktuar.

Kontraktuesi do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha PGM e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, nga ora 7.00 deri 15.00.

Këto janë parashikuar për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të PGM sipas grafikut bashkëngjitur.



### **3.2 Specifikime teknike dhe metodologjia.**

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të pikave te grumbullimit te mbetjeve të akseve kryesore, konsiston në:

- a.** Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të pikave te grumbullimit te mbetjeve, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogëla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet përreth tyre, si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve.
- b.** Në rastet e evidentimit të mjë problematike të tillë, lajmërohet Kontraktuesi, i cili brënda 1 ore duhet të eliminojë problemin . Në të kundërt, penalizohet.
- c.** Edukojë dhe komunikojë me popullsinë për sa i përket praktikave të mira dhe të këqija në përdorimin e kazaneve dhe pikave të grumbullimit.

### **3.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve**

- a.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i pikave te grumbullimit te mbetjeve do të bëhet gjatë ditës nga ora 7.00 deri 15.00
- b.** Mirëmbajtja dhe pastrimi i pikave te grumbullimit te mbetjeve do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës pikave te grumbullimit te mbetjeve e përcaktuar për shërbim të jenë kryesisht e pastër ose duke u pastruar.
- c.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktori. Kontraktori nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- d.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penaltete , gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

### **3.4 Regulla për tu zbatuar**

- a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen pikave te grumbullimit te mbetjeve të papastruara apo të mbushura me mbeturina. Në të gjitha rastet kur evidentohen raste të tilla, pikave te grumbullimit te mbetjeve e papastruar, lajmërohet Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet menjëherë të marrë masa për pastrimin e tyre brenda 1 ore nga njohja e problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.
- b.** Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohe të këtij shërbimi.

c. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mos plotësimin e tyre.

Mjetet dhe pajisjet

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore.

#### **4. Dezinifektimi i pikave të grumbullimit të mjeteve**

##### **4.1 Volumi i punimeve**

a. Duhet të bëhet dezinfektimi i zonës për rreth Kontenierëve, pas zbrasjes së çdo kontenier, me pluhur gjëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezinfektimit manual, duke përdorur të tretur lëndën pluhur të gjëlqeres me 5% përmbajtje klori.

b. Frekuenca e dezinfektimit është 2 herë në javë për periudhën Maj-Shtator ( ditët e mërkure dhe të shtunë), ndërsa periudhën tjetër të vitit , Tetor-Prill 2 herë në muaj.

#### **5. Lagia e rrugëve me makinë teknologjike**

##### **5.1 Volumet e Punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e lagies dy here ne dite ne oraret e caktuara nga Autoriteti Kontraktues

1. Operatori i shërbimit do të bëjë lagien ne menyre periodike të rrugëve e shesheve në një sipërfaqe të përgjithshme prej 64718 m<sup>2</sup> dy here ne dite per 214 dite te miratuara nga autoriteti kontraktor. Keto jane parashikuara ne listen e rrugeve dhe volumet e tyre per shërbimin e lagies me makineri teknologjike Per periudhen 14 Mars deri 13 Tetor me dy lagie ne dite duke filluar ne oren 06.00 te mengjesit simbas preventivot nr 3.

## 5.2 Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Largien me makineri teknologjike , si shërbim dy here në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që makinat të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

## 5.3 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1.Lagie e rrugëve, si shërbim dy herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.

2.Freskimi i rrugëve si shërbim i dytë ditor, do bëhet çdo ditë, gjatë periudhës 14 Mars – 13 Tetor.

3.Nuk është e nevojshme kryerja e lagies së parë të rrugëve (gjatë natës) në të gjitha ato segmente, ku në të njëjtën ditë korrespondon me kryerjen e shërbimit të larjes speciale.

4.Lagie me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontratues, me qëllim që në orën 07.00 dhe në orën 19.00 për shërbimin e dytë të lagies, zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e lagur.

5.Grafikët e punimeve per realizimin e shërbimeve të lagies së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

6.Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe intinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

7.Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

8.Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penaltete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

## **5.4 Rregulla për tu zbatuar**

1. Autoriteti kontratues ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve e ujit për lagje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për lagjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në lagje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i lagjes do të konsiderohet i pavlefshëm.

2. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e lagjes të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,4 litër ujë për 1 m<sup>2</sup> rrugë për lagjen.

3. Lagja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë.

4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të lagjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet. Ditët do të zevendesohen vetëm atëherë kur të rishikohet grafiku i punimeve nga autoriteti kontraktor.

5. Përfaqësuesit e Autoritetit kontratues do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i lagjes dhe mund të kërkojë Operatori i Shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve dhe sipërfaqeve të rrugëve sipas listës së rrugëve bashkëngjitur kontratës, një kërkesë zyrtare të Autoritetit kontratues, si dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.

6. Do të konsiderohet e pavlefshme lagja e rrugëve në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontratues për shkaqe të ndryshme.

7. Autoriteti kontratues do të nxisë Operatori i shërbimit të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për lagjen e rrugëve, si puse, etj.

8. Listat përkatëse të rrugëve që do të lagen i bashkëngjiten kësaj kontrate.

9. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për lagje, do të mbarten nga operatori i shërbimit.

10. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për lagjen e rrugëve.

## **5.5 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e lagjes së rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të lagjes së rrugëve këto mjete:

1.Makina për lagjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për lagjen e rrugëve me presion, paisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtës jo më pak se 9500 litra ujë, jo më pak se 1 (nje) copë;

2.Automjetet të cilat duhet të përdoren për lagjen e rrugëve duhet të inspektohen jo më larg se 6 muaj nga Autoriteti kontratues. Çdo makineri për lagjen e rrugëve duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.

3. Boti për lagjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.

4.Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

5. Emri dhe telefoni publik i operatorit shërbimit ,targat dhe shkrimi “Mbani qytetin Tuaj të pastër”duhet të jenë të dukshme në automjetet e fshirjes së rrugëve, ku shkronjat duhet të jenë të pakten 10 cm.

## **6.Mirëmbajtja e pikave të grumbullimit të mbetjeve**

### **6.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe vendosjen e 280 kontenierëve 1100 litra dhe të 50 kontinjereve në Spille. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në bashkinë rrogozhine si dhe në hartën bashkëngjitur kësaj kontrate.

### **6.2 Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

